



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr. 439/24  
Data. 13.05.24



Prishtinë, 13 maj 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2020\_2024

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084), Nenin 22 paragrafi 4 të Ligjit për Konfliktet Administrative (Nr. 03/L-202), dhe Kërkesën e datës 10.05.2024 të Kompanisë Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS), për shtyrje të ekzekutimit të vendimit V\_1929\_2024 të datës 05.04.2024 të nxjerr nga ZRRE,

në seancën e mbajtur me datë 13 maj 2024 merr këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** – si e pabazuar kërkesa e parashtruesit Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS), me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V\_1929\_2024 të datës 05.04.2024 i nxjerr nga Zyra e Rregullatorit për Energji, deri në vendimin definitiv gjyqësor.

### A r s y e t i m

Parashtruesi Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS), pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit V\_1929\_2024 të datës 05.04.2024, me të cilin Vendim janë Obliguar Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS), për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që të bëjnë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike, në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe atë, për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017.

Parashtruesi ka njoftuar se me datën 07.05.2024 ka parashtruar padi në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me palën paditëse KEDS, të paditur ZRRE dhe personit të tretë Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës me objekt të kontestit anulimin e vendimit të ZRRE.

Parashtruesi në propozimin e tij për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit pretendon se janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit pasi që pretendon se dëmi që pëson KEDS nga ekzekutimi i Vendimit të ZRRE konsiston me zvogëlimin e të hyrave me të cilat KEDS përballon shpenzimet për realizimin e investimeve të nevojshme për operim, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes. Gjithashtu parashtruesi pretendon se është detyruar të publikoj në pasqyrat e



tij financiare vlerën e detyrimit që i ka ngarkuar Vendimi i ZRRE, ku sipas tij kjo sjellë që bankat dhe/ose institucionet financiare (i) do të rrisin interesat për financimin që mund t'i akordojnë KEDS për përballimin e shpenzimeve të aktivitetit me kapital qarkullues. Dëmi që KEDS do të pësoj do të ishte shumë i vështirë ose i pamundur për tu riparuar, nëse Gjykata Komerçiale vendos të anuloj Vendimin e ZRRE.

Gjithashtu parashtruesi pretendon se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ZRRE nuk është në kundërshtim me interesin publik. Interesi publik synon zbatimin e drejt të Ligjit. Konkretisht, Vendimi i ZRRE është i bazuar në një aktgjykim të padrejtë. Poashtu parashtruesi pretendon se Aktgjykimi dhe zbatimi i tij kundërshtojnë KEDS nga ana e ZRRE përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Parashtruesi po ashtu pretendon se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ZRRE nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh as ZRRE, si palë kundërshtare dhe as Avokatit të Popullit, si person i interesuar, përkundrazi shtyrja do t'i jap mundësi palëve që të shmangin ardhjen e dëmit për KEDS, i cili është vështirë i riparueshëm apo tërësisht i pamundur për tu riparuar, i cili dëm mund të kthehej në problem për rrjetin e shpërndarjes, për rrjedhojë e të gjithë konsumatorëve në Republikën e Kosovës.

ZRRE me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, është referuar në Nenin 22 par. 2 të Ligjit nr. 03/L-202 për konfliktet Administrative (LKA), i cili përcakton se *“ Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyj ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”*.

Bazuar në Nenin 22 par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara: a) ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej; b) shtyrja të mos jetë në kundërshtim me interesin publik, dhe c) shtyrja nuk do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

ZRRE me shumë kujdes ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të paraqitura në kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit dhe vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që parashtruesi pretendimet e paraqitura në propozim nuk i ka mbështetur në prova materiale pra, nuk ka dëshmuar prova me të cilën do të vërtetohej se të njëjtit do të shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte ligjore këto të përcaktuara me Nenin 22 par. 2 të LKA-së.

ZRRE vlerësoi se pretendimet e paraqitura në propozim nga parashtruesi, se ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit dhe mund të rëndoj pozitën e parashtruesit të kërkesës për shkak të obligimit të shërbimit publik të cilën ZRRE e ka potencuar edhe në rastin e shqyrtimit gjyqësor, nuk është qëndrueshëm sepse edhe moszbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese do ta rëndonte interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorëve, të drejtën e kompensimit të cilën ua ka njohur gjykata përmes Aktgjykimit dhe do të ishte në kundërshtim me Aktgjykimin e Gjykatës.





ZRRE po ashtu vlerësoi si të pabazuara pretendimet e parashtruesit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, pasi që të gjitha pretendimet e parashtruesit nuk janë të mbështetura në prova ligjore materiale, pasi i njëjti pretendimin e saj e mbështet në atë se Vendimi i ZRRE është i bazuar në një Aktgjykim të pa drejt, duke theksuar se Aktgjykimi dhe zbatimi i tij kundrejt KEDS nga ana e ZRRE përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

ZRRE vlerëson se përmes vendimit vetëm ka zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/2017 të datës 15.09.2021, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. 990/2021 të datës 04.10.2021, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ARJ.nr. 116/2022 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI.103/23 të datës 11 mars 2024, për faktin se këto Aktgjykime kanë karakter të detyrueshëm të zbatimit në kuptim të Nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

ZRRE sqaron se me datë 11 mars 2024 nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pranuar Aktgjykimin Nr. KI.103/23, me të cilën pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ.nr. 116/2022 të datës 09 mars 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se ky Aktgjykim nuk është në kundërshtim me par. 1 të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Kosovës në konflikt administrativ përmes Aktgjykimit ARJ.nr. 116/2022 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit A.A.nr. 990/21 të datës 04.10.2022.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.A. nr. 990/21 të datës 04.10.2022 ka refuzuar ankesës, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 1373/17 të datës 15.09.2021 e ka vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr. 1373/2017 të datës 15.09.2021 nën pikën II. ka vendosur që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë Nr. V\_399\_2012 i dt. 06.02.2012 dhe Detyrohet e paditura që të ndër marr veprime që e obligojnë shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë SH.A. (KEDS) në Prishtinë, që të bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve të cilët janë faturuar për shpenzimet e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, dhe atë për periudhën kohore nga dt. 06.02.2012 e deri më dt. 20.10.2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë Euro (40,855,480.00 €).

ZRRE, pas pranimit të Aktgjykimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me këto Aktgjykime ka ndërmarr veprime ligjore për zbatim në pikëpamje juridike të gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, pra ZRRE përmes vendimit ka zbatuar këto Aktgjykime.

ZRRE i vlerëson si jo relevante me çështjen pretendimet se shtyrja e ekzekutimit të vendimit do të ishte në mbrojtje të interesit publik pasi që ekzekutimi do të jepte efekte të dëmshme dhe do të kishte impakt negativ tek konsumatorët, pasi që ZRRE me Vendimin e kontestuar nuk ka ndërmarr veprime kufizuese, por vetëm ka zbatuar një Aktgjykim të Gjykatës ashtu siç ka vendosur edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, dhe shtyrja e ekzekutimit të vendimit do të ishte në kundërshtim me interesin publik.




ZRRE po ashtu i gjeti si të pa bazuara pretendimet e parashtruesit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh ZRRE-së apo palës së interesuar, sepse ashtu siç u argumentua më lartë nuk provohet se parashtruesit i shkaktohet dëm i cili vështirë se do të riparohej, pasi që në rastin konkret me vendimin e kontestuar është zbatuar vetëm Aktgjykimi i gjykatës.

Andaj, ZRRE me këtë rast vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, pasi këto pretendime në rastin konkret nuk janë me ndikim me rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, pasi që nuk janë plotësuar kushtet në mënyrë kumulative si në kuptim të Nenit 22 të LKA-së.


- II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar

  
Arta Isufi, Anëtare

  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KEDS SH.A.
- Avokatit të Popullit,
- Gjykatës Komerciale dhe
- Arkivit të ZRRE-së